



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjyqësor e deklaroi të mbyllur fazën e paraqitjes së provave dhe caktoi datat për paraqitjen e deklaratave përmbyllëse nga 15 deri më 19 prill 2024.

Sipas Rregullores, pas deklaratave përmbyllëse, kryegjykatësi i Trupit Gjyqësor e deklaroi të mbyllur çështjen gjyqësore. Pas mbylljes së çështjes gjyqësore, Trupi Gjyqësor fillon fazën e kuvendimeve. Aktgjykimi duhet të shqiptohet brenda 90 ditësh pas mbylljes së çështjes gjyqësore, përveç nëse, për shkak të rrethanave, kërkohet zgjatje e afatit.

Krahas caktimit të datave për deklaratat përmbyllëse, gjykatësit ftuan Mbrojtësin e Viktimave të paraqesë kërkesë për zhdëmtim për dëmin fizik, mendor dhe/ose material që pretendohet se është pësuar (nga secila) prej viktimave pjesëmarrëse në proces, nëse ka, deri më 4 mars.

Trupi Gjyqësor I gjithashtu ftoi Prokurorinë, Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave që të dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare përkatëse, dhe Mbrojtësin e Viktimave që të dorëzojë deklaratën në lidhje me pasojat e shkaktuara nga veprat penale të pretenduara tek viktimat deri më 25 mars.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, këtë javë kanë dhënë dëshmi dëshmitarët e 45-të dhe 46-të të thirrur nga Prokuroria, kryesisht në seanca publike. Duke filluar nga e marta, dëshmitari i dyzetegjashtë dëshmoi me pseudonim, por pa ndryshim të pamjes apo të zërit, lidhur me rrëmbimin e anëtarëve të familjes së tij në zonën e Rahovecit.

Të martën pasdite, një ish-epror i UÇK-së, Hajrush Kurtaj, vijoi dhënien e dëshmisë që e kishte filluar më herët këtë muaj. Dëshmia e Hajrush Kurtajt vazhdoi të mërkurën dhe të enjten.

Pas seancës së rregullt të gjyqimit të ditës së djeshme, Trupi Gjyqësor II mbajti një seancë të veçantë për të diskutuar kalendarin dhe aspekte të planifikimit të gjyqimit, përfshirë mundësinë e thjeshtimit të provave të paraqitura nga Prokuroria, si edhe marrjen e masave që më shumë seanca gjyqësore të bëhen publike.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, javën e kaluar u dorëzuan parashtrime publike lidhur me ndryshimin e mbrojtësit dhe bashkëmbrojtësit të dy prej të akuzuarve.

Më 16 shkurt, Administratorja e DHSK-së e informoi Trupin Gjyqësor për përfundimin e emërimit të Dejvid Jang si bashkëmbrojtës i z. Rexhep Selimi.





Pasi Trupi Gjykes miratoi tërheqjen e Gregori Kihout si kryembrojtës i z. Hashim Thaçi, Administratorja emëroi Luka Mishetiçin kryembrojtës të Hashim Thaçit, më 19 shkurt. Gjatë seancës së 20 shkurtit, Trupi Gjykes i dha urdhër gojor Luka Mishetiçit që të dorëzojë listën e përditësuar të ekipit të Mbrojtjes së Thaçit deri më 11 mars.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 15 shkurt, Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, në vendime më vete për secilin.

Për të dy të akuzuarit, gjykatësit konstatuan se vazhdon të ekzistojë rreziku që ata të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë vepra të tjera penale ndaj personave që konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë gjykim. Trupi Gjykes vazhdoi të ishte i mendimit se këto rreziqe mund të zvogëlohen vetëm nëpërmjet kornizës së monitorimit të komunikimeve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, ku përfshihen edhe masat e urdhëruara kohët e fundit nga Trupi Gjykes.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykes konstatoi më 16 shkurt se disa pjesë të transkriptit të dëshmisë së një dëshmitari mund të riklasifikohen si publike.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, Prokuroria ka dorëzuar dosjen paraprake së bashku me listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë dhe listën e provave materiale që propozon të paraqesë gjatë gjykimit për vërtetimin e akuzave.

Më 21 shkurt, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Vetëm që është caktuar të mbikëqyrë zbatimin nga Administratorja të urdhrit për zhdëmtime të Trupit Gjykes I në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, lidhur me emërimin e z. Julius von Bone si mbrojtës të z. Mustafa.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

